

MIMOZA AHMETI
BËHU I BUKUR
POEZI

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Portreti: M. Ahmeti nga Besim Golemi, vaj, 1988

ISBN 978-9928-277-21-3

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Mimoza Ahmeti

Bëhu i bukur

poezi

Me parathënie nga
Aurel Plasari

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Ky vëllim është një përmbledhje e poezive të mia që u shkruan kryesisht midis viteve 1982-1988.

Bëhu i bukur, titulli që mban edhe përmbledhja, është marrë nga vëllimi im i parë, 1986, që tërhoqi vëmendjen e brezit dhe dha shpresë për një tjetër njohje.

Një pjesë e këtyre poezive nuk mundën ta shikonin dritën e botimit në atë kohë, për arsye të censurës.

Disa prej poezive edhe u hoqën nga libri *Sidomos nesër* (1988), Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, pasi qenë botuar. Libri u pengua nga qarkullimi për disa muaj dhe doli pasi u ricensurua. Në një Plenum të Komitetit Qendror për Letërsinë, të asaj kohe, poezitë u quajtën “Re të zeza në horizontin e letërsisë shqipe”.

Mimoza Ahmeti mbetet mirënjohëse për ata shokë dhe miq, studentë e më gjerë, që i patën në duar këto vargje, fletoret e saj të plota, i kaluan dorë më dorë dhe nuk bënë asokohe asnjë kallëzim.

Me sa duket, transformimet shoqërore ndodhin kur vetë njerëzit bëhen të vetëdijshëm për to dhe kanë bonsens për të pranuar ndryshimin.

Autorja

MIMOZA AHMETI NË POEZINË E VITEVE '80

Në mesin e viteve '80 shfaqeshin në letërsinë shqipe shenjat e një paradigme të re poetike. Ndonëse pak e përshkruar prej historisë së kësaj letërsie, ajo tanimë i përket. Prandaj, falë njohjes prej punës së atëhershme në shtypin letrar, e gjej këtë rast për t'ia bërë ndonjë ravijëzim:

Ishin vite gjatë të cilave në letërsinë shqipe spikatnin ndryshime cilësore gjuhe, - pikësëpari gjuhe, - që gjenin shprehje veçan te poezia. Natyra metaforike e poezisë mundësonte gjithnjë më shumë komunikimin e mirëfilltë publik nëpërmjet mesazhesh të kriptuara si mënyrë specifike e përcjelljes së një ndërgjegjeje kolektive në shndërrim. Të lexoje poezi, të përktheje poetë, që atëherë emërtoheshin “të huaj”, sidomos nga ata “të ndaluarit”, aq më shumë të shkruaje vetë poezi, ishte në ato vite si të kryeje diskurse provokuese për nga emocioni dhe befasia e depërtimit në botën e ndjenjave.

Shoqëria qytetare, në përgjithësi, kishte ndjeshmëri të veçantë ndaj artit, ndaj poezisë edhe më shumë, si përfaqësues i së pathënës dhe/ose njëherësh të pathënshmes. Poeti dhe artisti rrethoheshin me një vëmendje që përftonte atë rezonancë, e cila bënte të mundur frymëzimin krijues dhe funksiononte si fushë tërheqëse magnetike sa midis botimit dhe leximit si fenomen, aq

edhe midis librit dhe lexuesit si intimitet. Sot mund ta përshkruaj si një mision të pashprehur, por të qartë e të shumëpritur nga ai që e quajmë horizonti i pritjes, - për të përdorur një koncept të estetikës së receptimit, - i hapur ndaj drejtpërdrejtësisë së fjalës dhe thyerjes së skemave.

Megjithëkëtë, nuk mund të thuhet se panorama e “poezisë së re”, që i ofrohej horizontit të pritjes në vitet ’80, zotërohej nga kjo paradigmë. Në panoramën e poezisë së atij dhjetëvjetëshi vijonin të regjistroheshin simptomat e një patologjie poetike zhgënjyese për horizontin përkatës të pritjes. Nuk ishte fjala për poezinë servile, as konkretisht për atë kushtuar “Partisë”. Sepse dhe Partisë mund t’i këndoje me dinjitet poetik sikurse i kishin kënduar paraardhës të shquar. Problemi qëndronte te përftimi i një idilizmi socialist, të ngjyrosur si *kitch* i një akuareli, i cili ia bjernte poezisë frymën që do të duhej të përfaqësonte vetë thelbin e saj.

Afërmendsh që jo të gjithë përfaqësuesit e breznisë në fjalë e vuanin këtë patologji. Vinin të ndryshëm një Mujë Buçpapaj nga Tropoja, me gjenuinitetin e natyrshëm të maleve, ose një Vasil Dilo me përjetimet intimiste nga Gjirokastra, sa për të kujtuar dy shembuj.

Asaj patologjie zhgënjyese po fillonte t’i binte ndesh poezia e Mimoza Ahmetit, që e shqiptonte refuzimin deri edhe në një poezi me titull drejtazi *S’i dua*: “*S’i dua mendimet e palosura/ si sirtarët e pajës,/ as si flokë të shkuara rresht bigudinash/ s’i dua,/ mendimet le të shpërthejnë...*”. Qenë vargje pothuaj naive të një gjimnazisteje, të përfshira atëherë në njërën nga përmbledhjet me “letrarë të rinj”.

Individualiteti poetik i Mimoza Ahmetit rezultonte kështu, në atë mes vitesh '80, në kërkim të një tjetër cilësie asociimi: drejt mendimit në lëvizje dramatike ndjenjash. I tillë i shfaqej individualiteti, i realizuar në përmbledhjen e saj të parë me poezi *Bëhu i bukur!* (1986). Kryetari i Lidhjes së atëhershme të Shkrimtarëve, Dritëro Agolli, e quajti zërin e saj “një instrument poetik”, ndërsa thuhej që njëri ndër “shkrimtarët e mëdhenj” e paskësh krahasuar, mbase për asociim antroponimik, me “Ahmatovën”.

Me përmbledhjen e saj të parë me poezi *Bëhu i bukur!* ajo shihej tanimë si një *vedette* e breznisë së vet: jo vetëm nga studentët në qarqet universitare dhe nga lexuesit nëpër rrethe, por nga ata të dashuruar që besonin te *Bëhu i bukur!* Madje edhe nga të përndjekur e të burgosur politikë që i komentonin dhe i qarkullonin vargjet e saj dorë më dorë, siç do të dëshmohej.

* **

Kush ishte atëherë Mimoza Ahmeti?

Ishte një studente e Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, në degën e Gjuhës dhe të Letërsisë shqipe. Vishej dhe mbahej në mënyrë jo të zakonshme për kohën dhe brezninë: gjithmonë pantallona, më të ngushta ose më të gjera sesa të tjerët; flokët të prerë shumë shkurt; në vend të këpucëve “opinga moderne”, me gjasë nga qyteti i saj i lindjes (Krujë); më së shumti me duart në xhepa. Për të vinte më se i besueshëm vargu i saj: “*Me cironka të shpejta mendimesh në kokë më pëlqen të eci...*”. Madje, me “cironka” në kokë ose pa to, ajo guxonte të dilte e të bënte patinazh

nga kodrat e liqenit artificial kur këtë shumë rrallë e bënin edhe djemtë. Të kishte qenë në një vend tjetër dhe kohë tjetër, do të kishte prodhuar modë si aktorja Sarah Bernhardt, por në atë kohë, kur edhe vetë koncepti “modë” ishte jashtë mode, ajo as që e njihte aktoren ekstravagante. (Tregohet se dikur, në moshë më të madhe, Sarah Bernhardti përfundoi të përdorte në vend të shtratit për gjumë një “arkë”.) Si për kontrast të ekstravagancës së jashtme, tregonin se në Fakultet ishte studente e shkëlqyer, me sjellje krejt të qetë. Që ishte vetmitare, e tillë ishte pothuajse gjithmonë, por pikërisht prandaj edhe e rrethuar nga një kureshtje e kuptueshme, pra joshëse.

Ajo nuk njihte në atë kohë as Ahmatovën, me të cilën e paskëshin krahasuar: Ahmatova në ato kohë nuk studiohej në Fakultetin tonë, përmendej rrëshqitas vetëm për sharzhet e Zhdanovit kundër saj: “diçka mes prostitutës dhe murgeshës”. Të kishte parë portretet e Ahmatovës në të ri, do të kishte vënë re që edhe balluket mbi ballë i mbante ngjashëm me akmeisten ruse. Mimoza Ahmeti nuk dinte as se ç’ishte “realizmi akmeist”, me të cilin Anna Ahmatova pati provokuar horizontin e pritjes së kohës së vet. Por kthjelltësia dhe papritshmëria e **teptisjes** së vargut të saj, virgjëria me të cilën ushqej dashuria për jetën dhe njeriun, posaçërisht aspirata për një tjetër mënyrë përftimi dhe ekzistimi, veçanërisht *të bukur*, e dalluan poezinë e saj nga ato të standardizuarat e atëhershme.

Elementi autoreferencial, që në poezinë e saj qet krye edhe aty ku nuk e pret, iu vu re qysh në botimin e përmbledhjes së parë si karakteristikë e pangatërrueshme e poezisë së saj. Ishte njëra nga arsyet e suksesit të asaj poezie. Por, ta përfillësh vetëm

nga kjo karakteristikë, do të shkaktonte një ekuivok të dëmshëm në vlerësimin e poezisë së Mimoza Ahmetit, në të cilën elementi “kritik-artistik” është shumë më i pranishëm nga sa mund të pandehet. A thua se në fund të dekompozimit dhe rënies gati “natyrore” të një diktature afërisht 50-vjeçare si sistem izolimi, talenti krijues i Mimoza Ahmetit ia përkushtonte botën e ndjenjave triumfit të subjektit të njeriut dhe shpresës për një të nesërme humane. Një numër poezish, të viteve ’80, botuar vetëm në vitet ’90, do ta përforconin këtë përkushtim. Po përmend njëjërën:

PUNËTORËT E KRASTËS

Do të ndalet. Pas pak do të ndalet urbani.

Do të zbulojnë sytë e tij punëtorët e Krastës.

*Të zhveshur, si eshka të thara, gurë të heshtur,
paditje solide, grup në stacion.*

Do të ndalet urbani, do të hipin ata.

Si gurët e Krastës do të hipin, pa zhurmë.

Por, ah, sa e tmerrshme ngjitja e tyre!

Ai vështrim i uritur, i heshtur.

Ajo bardhësi e gurit të gëlqeres në fytyrat e heshtura.

Flokë të gëlqerosura, të heshtura.

Frymëmarrje mielli e heshtur.

Asnjë vend i lirë për ta, asnjë.

Dhe kur urbani është plot e s’ndalon dot:

lë pas, oh, ç’tmerr, atë padi solide fytyrash gëlqerore,

*e cila me sy të uritur, me një uri të gjatë të ndjek.
 Krasta është më e frikshme se Ferri
 atë natë.*

1985

Kontrast gërthitës bënte ky qëndrim sidomos me atë cinizëm egocentrik, antihuman, që kishte kontaminuar pjesën në atë kohë “tradicionale” të poezisë shqipe. Në këtë bashkëkohësi të efuzionit spontan ndjenjësor, nga njëra anë, dhe kontrollit të medituar, nga tjetra, do të duhet vështruar domethënira reale e Mimoza Ahmetit si poete, qoftë për ç’i përket lidhjes me lëvizjen poetike të kohës së saj, qoftë për vendin që në poezinë shqipe bashkëkohore i takon.

E përthyer në një rrafsh origjinal gjuhësor, kjo lëvizje efuzioni mbante në vetvete sa ekzaltimin, aq edhe riskun për themeluesen e atij farë “neo-akmeizmi” shqiptar.

* * *

Është pak të thuash që në ato vite të bëheshe poet ishte si të rroje në një dridhtim ekstaze, ku ndërgjegjja jote bëhej e të tjerëve me shpejtësinë e botimit në gazetatat, revistat, qoftë edhe në stendat letrare të kohës, aq më shumë me botimet *libër*. Syri vigjilues i censurës nuk reshtte së vëzhguari. Censura jo vetëm kërcënonte, por edhe vepronte, duke u bërë shtrëngim stili e duke kaluar deri në autocensurë. Autocensurë po, sepse si poete Mimoza Ahmeti e ndjeu herët - shumë herët - se ç’e priste në poezinë

shqipe. Krijimin e saj *Ars poetica*, të atyre viteve, do ta cilësoj paradigmatic për këtë ndjesi:

ARS POETICA

*Ka ngrirë boja në shishe,
gishtërinjtë mpirë në xhepa,
mendimi - pezull në nerv
pa mundur të vijë gjer në buzë,
ka ngrirë dashuria:
akull,
qelq,
krisur në zemër;
dielli poetik s'i ngroh më jetët.*

Mërdhijnë poetët.

Ishte poezia që do të botohej e përshtatur, me sugjerimin e njërit prej redaktorëve të shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, si vijon:

ART POETIK

*Vetëm po të ngrinte boja në shishe,
gishtërinjtë të mpiheshin në xhepa,*

*mendimi - pezull në nerv
 pa mundur të vinte gjer në buzë,
 vetëm po të ngrinte dashuria:
 akull,
 qelq,
 krisur në zemër;
 dielli poetik s'do t'i ngrohete më jetët.*

Do mërdhinin poetët.

Në të vërtetë as goditja e censurës nuk do të vononte: ajo do të binte mbi përmbledhjen e dytë të poetes: *Sidomos nesër* (1988). I shtypur, libri u bllokua dhe nuk u lejua të qarkullonte. Ulje-ngritjet e goditjes më ka takuar t'i ndiqja nga afër. Redaktor i librit ishte Dritëro Agolli, atëherë jo vetëm kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, por edhe anëtar i KQ të PPSH-së. Acarimi i censurës duhej të kishte qenë aq i madh, sa të mos ngurronte ta shpërfillte edhe autoritetin e tij. Alfred Uçi, kryetar i Komitetit të Kulturës dhe Arteve, siç quhej njëfarë ministrie e atëhershme e kulturës, zhvilloi betejën e vet në mbrojtje të librit.

Ulje-ngritjet e goditjes së censurës përfunduan me një zgjidhje kompromisi, por gjithsesi kompromisi censuror: libri do të lejohej të qarkullonte vetëm pasi iu grisën pesë poezi dhe në vend të faqeve të grisura u ngjitën pesë të tjera, “të parrezikshme”. Pos kësaj, librit iu hoq dhe iu ndërrua edhe kopertina e punuar prej piktores atëherë të re, Xhilda Paloka: dy duar gati-skeletore, të ngërthyera në mënyrë sensuale, u zëvendësuan me një lule të vogël. Deri edhe fotoja e poetes u hoq nga kopertina e mbrapme.

Kam pas dalë qysh atëherë në përfundimin që zgjidhja e kompromisit u bë jo për ta “shpëtuar” poeten dhe librin e saj, por për të kundërtën. Njëra ndër mendjet dinake të censurës do të këtë parashikuar që dënimi tërësor, në atë vit 1988, i përmbledhjes poetike të një 25-vjeçareje mund të rrezikonte ta bënte atë të njohur edhe përtej Shqipërisë, qoftë edhe më vonë. Pati ndodhur në Rumaninë e rrethanave të ngjashme, po më 1988, kur censurimi i përmbledhjes së poetit Mircea Dinescu *Vdekja lexon gazetën* shkaktoi botimin e saj të papritur në Amsterdam. E ndaluar dhe e vonuar, fama europiane do t’i njihej Mimoza Ahmetit dhjetë vjet më vonë, kur në Festivalin Ndërkombëtar “Sanremo 1998” iu dha “Palma e Artë” për poezinë *Asgjësë tërësore* prej një jurie të përfaqësuar nga 27 vende të botës.

Një ekzemplar origjinal të pacenuar të përmbledhjes *Sidomos nesër*, të marrë prej shtypshkronjës me të cilën asokohe më lidhte puna, e ruaj ndër librat vetjakë. Pesë poezitë e grisura dhe të zëvendësuara të saj janë: *Orë njerëzore* (f. 18-19), *Do të doja* (f. 46), *Hiena* (f. 57), *Letra e fundit e V. Majakovskit* (f. 70-71). Po përse pesë? Një duhej të kishte qenë, në të vërtetë, poezia që do t’ia kishte shkelur censurës “thembrën”. Për mendimin tim u bënë pesë për të humbur gjurmën e “poezisë mëkatore”, e cila kishte ngrehur mekanizmin e censurës. Ç’është e vërteta, të pesta poezitë e dënuara ishin lirike me elemente intime. Dyshimi ynë binte mbi poezinë me titull *Hiena*. Por edhe ajo nuk ishte veçse lirikë dashurie. Sepse në libër mbeteshin poezi si *Këngë për Ljuis Ljakun*, në të cilën poetja guxonte të pohonte: “*Ti mos këndo, - më thua, - në këtë zi*”. Pikërisht kështu: “*në këtë zi*”.

Apo mosacarimin e censurës e kishte provokuar aludimi në përfundim të letrës së “Majakovskit”: *“Vrasësi i vërtetë do të shpëtojë/ dhe fare i qetë do të shëtisë kryeqytetit...”*?

Duket të ketë qenë ky njëri ndër modalitetet e censurës së asaj kohe, që dëshmon rastin kur çështja nuk varej as nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe as nga Komiteti i Kulturës e i Arteve, por i shkapërcente ato. Për autoritetet e kulturës u desh të kalonte ca kohë sa të përthahej “dregëza” - e mbaj mend këtë shprehje të Alfred Uçit, - që kryesia e Lidhjes t’i njihte poetes statusin e “Profesionistes së lirë” në Lidhjen e Shkrimtarëve.

Kam qenë dhe qëndroj kundër shpалosjes së kujtimeve nga jetët e shkrimtarëve, me përjashtim të atyre elementeve që mund të ndihmojnë për të kuptuar diçka më shumë nga vepra e tyre, siç e quaj ngjarjen që sapo kujtova.

* * *

Vitet ’90 përfaqësuan kthesë të befasishme zhvillimesh jo vetëm shqiptare, por mbarë globale: pritshmëri të reja u shfaqën në realitetin shqiptar në të njëjtën kohë që idealet do të shndërroheshin me të shpejtë nga utopi universale në struktura materiale pragmatike. Të tillë rezulton ta ketë përkapur realitetin e ri poezia e Mimoza Ahmetit.

Një krizë e besimit shfaqte simptomat e para, të cilat e transformonin filozofinë e ideale në filozofinë utilitare të ndryshimit. Përmbledhja poetike *Delirium* u botua më 1994, por në të janë përfshirë edhe poezi të gjysmës së dytë të viteve ’80, të cilat nuk ishte e mundur të botoheshin në përmbledhjen *Sidomos*

nesër, aq më pak te Bëhu i bukur! Kishin qarkulluar, gjithsesi, dorë më dorë dhe si të tilla qenë ruajtur.

Pothuaj i tjetërsuar në një ide unizimi filozofik, që zëvendësonte në tërësi mungesën, subjekti i jepte tani vargut poetik të autores një transcendencë universale, duke kaluar në një “përtejkohë”, pa detaje dhe pa përkime të jashtme historike. E gjithë “ngjarja poetike” tanimë zhvillohej në kohën e Unit, duke rrëmbyer me vete në këtë tejkapërcim edhe lexuesin. Të tilla do t’i përshkruaja poezitë: *Nocione të shkreta, Shqisë shqisë, Armiku im, Asgjësë tërësore, Delirium*, që i dha titullin përmbledhjes etj. Duke asnjësuar përmbajtjen e kontradiktës, ato kalojnë nga “poezi tendencioze” në “poezi të frymës jotendencioze”, sikurse i klasifikoi ciklet e përmbledhjes vetë autorja.

Përmbledhja *Delirium*, që u botua edhe në gjuhë të huaj dhe u ribotua disa herë, dilte në dritë vetëm një vit pas romanit *Arkitrau* të autores; romani i kushtohej dashurisë pa dallim për njeriun, dashurisë në të cilën zgjedhja e të dashurit, siç thoshte autorja, ishte çështje rastësie dhe në të cilën njerëzit dashurohen të gjithë “me të njëjtën zemër”. Ka gjasë të kenë qenë vitet 97-98, nga më të vështirat për shoqërinë shqiptare, të cilat patën ndikuar që autorja të merrej më së shumti me prozë, me *short stories*, zhanër i filluar që para vitit 1996 dhe që u përmbloodh nën titullin *Absurdi koordinativ* (1996). Edhe titulli linte të nënkuptohet që vendndodhja hapësinore (“koordinatat”) dhe përfaqësimi imponues i qytetërimit bashkëkohor, nëpërmjet klasifikimit historiko-nacional, përbënin për poeten në thelb një absurd. Kjo përmbledhje përfaqëson ndoshta limitin e shthurjes logjike dhe gjuhësore të shkrimtares Mimoza Ahmeti. Për këtë arsye këto

“tregime” i kam quajtur më shumë një poezi e shtrirë narrative, sesa prozë.

Zhvillime të reja në veprën e autores solli “shekulli i ri”: një patos ngacmues në përmbledhjen me poezi *Pjalmimi i luleve* (2003). Mund ta përshkruaja si libër që i bën thirrje jetës përtej dekompozimit gjigant të besimit, si dhe përtej zhgënjimit. Vijnë mbas tij dy libra në “prozë”: *Gruaja halucinante* (2006) dhe *Ich liebe dich Adlia* (2008), në të cilët shfaqen përmasa të reja ndjenjësore. Specifika të këtij zhanri të ri për autoren janë jo vetëm elementet e reja të stilit, por për më shumë argumentet e reja humane me anë të të cilave Ahmeti orvatet të ndriçojë modelin e një të ardhmeje. Duke iu kthyer poezisë më 2017, me *Librin e lumturisë* poetja pohon të ketë vënë në diskutim dimensionin dhe thellësinë e fundamenteve botëkuptimore. Sa për përfshirjet e Mimoza Ahmetit në fusha të ndryshme të artit, - pikturë vaji, akualet dhe vizatim, kompozim dhe interpretim etj., - ato i dalin jashtë suaze kësaj parathënieje.

Aurel Plasari

“Mimoza Ahmeti from Kruja is one of the ‘enfants terribles’ of the nineties, who set about to expand the horizons and explore the possibilities offered to her by her own senses. Dragging the nation, in her idiosyncratic manner, along the bumpy road to Europe, she has managed in recent years to provoke Albania’s impoverished and weary society into much needed reflection which, with time, may lead to new and more sincerely human values. After two volumes of verse in the late eighties, it was the fifty-three poems in the collection *Delirium* (Delirium), Tirana 1994, which caught the public’s attention. Mimoza Ahmeti’s poetry has been well received by the new generation of readers in tune, for the first time, with Western culture. Her candid expressions of wide-eyed feminine desire and indulgence in sensual pleasures, and the crystalline fluidity of her language have already made of her a modern classic. The traditional polarization of male and female verse would seem to dissolve under the passionate force of her quill.”

Robert Elsie

“Mimoza Ahmeti nga Kruja është një nga ‘fëmijët terribël’ të viteve nëntëdhjetë, që ia ka dalë të zmadhojë horizontet dhe të eksplorojë mundësitë e ofruara nga shqisimet e saj. Duke e tërhequr zvarrë kombin e vet, në mënyrën e saj idiosinkratike, në rrugën plot gropa drejt Europës, ajo ia ka arritur në vite të provokojë shoqërinë e varfër dhe të lodhur shqiptare, në më shumë reflektim të nevojshëm, gjë e cila, me kohë, mund të çojë te vlera të reja dhe më të sigqerta humane. Pas dy vëllimeve me vargje të saj, në fund të viteve tetëdhjetë, ishte përmbledhja me 53 poema, *Delirium*, Tiranë, 1994, që rroku vëmendjen e publikut.

Shprehja e saj e çiltër, me vështirimin e gjerë të një dëshire feminine dhe indulgjenca në kënaqësitë sensuale, si dhe fluiditeti kristalin i gjuhës së saj, e kanë bërë atë një autore moderne klasike.

Dallimi tradicional mashkull-femër i vargjeve duket se shpërbëhet nga forca pasionante e penës të saj.”

Robert Elsie



Bëhu i bukur

Bëhu i bukur sonte!

Dëbo grindjet, largimet dhe heshtjen e vrazhdë nga kujtesa.

Sillmë ndër mend mua.

Dhe veten!

Eja duke kënduar një këngë burri për jetën!

S'ka rëndësi se qysh, veç thuaja këngës trime,
me një tufë ëndrrash si tufë zogjsh
hapur në mijëra drejtime!

Jo i vogël në shpirt,
as i ngushtë!

Sonte

të dua të gjallë e të çlirë si natyra
dhe Njeri - zotërues i natyrës dhe vetes
gjithmonë!

Të dua pranë! Kuptomë!

Kam etje për krahët e tu mbi supet e mia,
për çlodhjen e kokës sime në qafën tënde
si në një qafë lisi!

Nuk të kërkon cektësia, por thellësia.
Të dua të ndershëm, të pakfjalë e të mençur;
të lodhur nga puna, kurrsesi nga jeta!
Të jesh i pastër, të biesh erë ujë si guri!
Të pafund të dua, të kem ku të mas vetveten!
Të dua të fuqishëm, të më ngresh pesh' të gjithë ç'jam - trup
e ëndërr!
Që pastaj, kur të kthehem, pas mbrëmjes
e gjer natën vonë, të shkruaj vargje
shumë herë më të bukura e më të guximta
nga këto që shkrova.



Kohë

Kohë pa të parë,
 kohë pa më parë,
 sonte ndiej frikë,
 pasiguri në k'të dhomë.
 Më duket sikur je diku-këtu,
 këtu - në të pacaktuarin drejtim,
 këtu - në të gjitha drejtimet.

Je pluhur i gjallë qe më bie nga supet,
 më derdhet nga buzët, qerpikët, flokët,
 kaq shumë të kam dashur,
 kaq shumë më ke dashur,
 sa s'mjaftojnë muajt dhe jetët s'mjaftojnë,
 të çdashurojmë,
 atë që dashurojmë.



Asgjë

Asgjë për të më thënë,
asgjë për të më dhënë
nuk kanë sytë e tu?

Duart e tua të mira
përse rrinë të mpira?
Asgjë për të më thënë?

Dikur ato më thoshin,
gjithçka duke më treguar,
duke m'i thënë të gjitha.

Dhe ti vetë më thoje,
kaq shumë më doje,
në netët e marrëzisë,
në netët e dashurisë.

Asgjë për të më thënë?
Asgjë për të më dhënë?

Dy koka të varura
në supe të rrëzuar,
dashuri e vdekur.
Të vdekur të dashuruar.



Net netësh

A do t'i kujtojmë ndonjëherë ato net netësh
kur unë dhe ti merrnim frymë dhe drurët prisnin,
kur yjet digjnin e hëna zmadhohej,
kur bari fëriste i tretur në ëndërr,
ato net netësh të prillit shkëlqyes!

Ah! Ku shpejtësia jote - një çiklist i bardhë,
ku vrapi im i lehtë, vetëm ajrin prekte!
Ku fluturimi, fluturimi, fluturimi,
gjer nata shpirtin jepte,
buzë agimi...



Gravurë

Rruga me stola dhe parku
Yjet të ndalur në drurë,
Hëna fiksuar në qiell
Si në gravurë.

Përse kaq e gjatë kjo heshtje
E thyejmë, më thua ti.
Dhe dorën ma merr në duar
Me ngrohtësi.

Do ndodhë apokalipsi
po të të puth një herë?
Nuk e besoj, mërmëris.
Dhe fjalët dridhen në erë.

Rruga u step e çuditur,
Yjet kuriozë në drurë,
Të jetë ëndërr kjo natë?
Të jetë gravurë?



Kur kthehesha ato net'

Kur kthehesha ato net,
kur kthehesha vetëm, pas orës dhjetë,
nën heshtjen e drurëve të qytetit të qetë,
yje herë shuheshin, herë shquheshin,
hënë nuk arrija të shihja,
kishte re
këtu-atje...

Kur kthehesha vetëm ato orë,
me prekjet dridhëse të ndjenjës,
në fytyrë, buzë, dorë,
me kaltërimin e hijeve poshtë syve
oh, e ndieja humbjen të më binte pas,
si hije,
si hije,
si hije...